



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.77

Prishtinë, më 30.4.2024, në orën 10:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225.

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ardian Gola, Albena Reshitaj, Eliza Hoxha, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza, Enis Kervan, Jahja Kokaj dhe Vlora Dumoshi, anëtarë.

**Munguan:** Adriana Matoshi dhe Ardian Kastrati.

**Pjesëmarrës tjerë:** anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, përfaqësues të OJQ-ve dhe mediat.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi** Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 16.4.2024;**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2022;**
- 4. Formimi i grupit punues për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.4.2024**

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 16.4.2024 u miratua pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit për Trashëgimi Kulturore për vitin 2022**

**Ardian Gola**, tha se raporti i punës së Këshillit për Trashëgimi Kulturore për vitin 2022, ka mbetur deri më tani pa shqyrtuar, meqë procedurat me Rregulloren e Punës parashohin që Komisioni për Buxhet Punë dhe Transfere, si dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave, kanë shqyrtuar dhe me vonesë kemi marrë raportin e tyre. Fjalën ia dha kryetares së Këshillit, për të prezantuar raportin për vitin 2022.

**Zanita Halimi**, tha se kemi pasur rastin të takohemi edhe për planin e performancës për vitin 2023, në të cilin janë përfshirë aktivitetet e ndërlydhura, që kanë përfshirë ecurinë dhe punën e raportit të vitit 2022, aktiviteve të kryera në vitin 2022 dhe gjendjen aktuale sot. Në vitin 2022, në planin e performancës, ne kemi pasur 3 objektiva kryesore: objektivi i parë, fuqizimi i mbrojtjes dhe gjendjes së trashëgimisë kulturore; objektivi i dytë, fuqizimi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; objektivi i tretë, promovimi i Trashëgimisë Kulturore të Kosovës dhe i punës së Këshillit për Trashëgimi Kulturore. Në objektivin e parë, në vitin 2022 kemi filluar me procesin e hulumtimit të vlerësimit të 23 aseteve në mbrojtje të përhershme, në vitin 2016 kemi rekomanduar që këto monumente dhe të tjera që kanë statusin e mbrojtjes, të funksionalizohen, të përgatiten planet e menaxhimit. Aktiviteti tjetër njihet si Këshilli i Vlerësimit të dosjeve për mbrojtje të përhershme. Gjatë vitit 2022, kemi propozuar 5 asete në mbrojtje të përhershme. Në raportin, të cilin e kemi dërguar, ka qenë si kërkesë e Komisionit që në raport t'i përfshijmë edhe vendimet se si janë të draftuara. Në raportin, të cilin e kemi dërguar për vitin 2023, i kemi dërguar të gjitha vendimet. Këshilli ka bashkëpunuar edhe me qendrat rajonale, është miratuar rregullore, dhe Qendra Historike e Prizrenit, tanimë ka marrë statusin e mbrojtjes së përhershme. Konferenca vjetore, të cilën e kemi mbajtur në vitin 2022, kryesisht është fokusuar tek aspektet dhe sfidat për edukim për rolin e trashëgimisë kulturore.

Objektivi i dytë është fuqizimi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, takime të rregullta të bordit, që shqyrtojmë edhe punën tonë, po ashtu edhe shqyrtimin e dosjeve, por edhe atë se çfarë është e rëndësishme tutje për trashëgimin kulturore, në përgjithësi. Është hulumtuar po ashtu edhe një pjesë e Qendrës Historike të Prizrenit, ku është monitoruar kjo pjesë, dhe në vitin 2023, ka përfunduar një pjesë e hulumtimit.

Objektivi i tretë, promovimi i punës së Këshillit për Trashëgimi Kulturore, kemi bashkëpunuar edhe me OSBE-në, ku na kanë ndihmuar edhe në hartimin e Rregullores 01, kur është bërë prezantimi i raportit dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Kosovë, në të cilin një prej rekomandimeve kryesore ka qenë ideja e përfshirjes së trashëgimisë kulturore shpirtërore, si pjesë e njohjes shtetërore, si dhe fuqizimi i bashkëpunimit më tepër me komunat që kanë parasysh potencialin e trashëgimisë kulturore dhe ta përfshijnë në zhvillimin e tyre të turizmit, të cilin ia ofron edhe komuna.

**Vlora Dumoshi**, tha se më intrigon pjesa te Hamami, një objekt i cili ka pasur një investim mjaft të madh, ka pasur ekspertët më të mirë të Turqisë dhe për 10 vite, tash sa bëhen, është i mbyllur.

Aty është punuar mjaft mirë e tash të shkatërrohet ai Hamam dhe për më shumë nga inatet mes zyrtarëve të Trashëgimisë edhe Komunës. Kërkoj të dijë se çka parasheh KKTK, faktikisht, kush e mori në menaxhim, çka po ndodh me këtë projekt, sepse kemi punuar në atë pjesë, sa kam qenë në komunë për ta funksionalizuar, por tashmë nuk është për Hamam, por ka qenë e paraparë për një qendër kulturore apo galeri për ngjarje të ndryshme.

**Ifeta Nikoqeviç**, tha se Hamami është në 5 asetet e para, të cilën Këshilli për Trashëgimi Kulturore ka propozuar për mbrojtje të përhershme dhe është aprovuar nga ministri. Me propozim të MKRS-së është kyçur edhe OSBE, për të ndihmuar me ekspertë profesionalë për studimin e fizibilitetit dhe të planit të menaxhimit të asetit të Hamamit të madh, por ka pasur qëndrime të ndryshme, që të jetë hamam, ka pasur qëndrime që të jetë qendër funksionale, dilema të cilat kanë ndikuar edhe gjatë vetë restaurimit të objektit. Prioritet është që të jetë një qendër multifunksionale, ka dilema ende që të përdoret si hamam, por është një rrezik i madh, sepse është një ndër asetet më të rëndësishme në qendrën e Prishtinës.

**Jahja Kokaj**, tha se është shumë e rëndësishme që raportin vjetor e keni ndërlidhur dhe hapur një mundësi për planin e performancës, një kontuitet të logjikshëm dhe shumë funksional në mes të raportit dhe planit funksional. Edhe pse po shqyrtohet me vonesë, sidoqoftë mua më pëlqen kontributi, aspiratat serioze dhe të mençura në restaurimin, konservimin dhe gjetjen e monumenteve, të cilat na përfaqësojnë si komb, sepse ardhmëria jonë varet nga e kaluara, d.m.th. ekziston një ekstrakulim, që mua më pëlqen me kaq pedanteri, me kaq profesionalizëm dhe në mënyrë artistike. Pra, edhe në nivel të artit e keni përcjellë këtë punë.

**Enis Kervan**, tha se më vjen mirë që janë zhvilluar këto takime edhe për çarshinë e Pejës dhe për Qendrën Historike të Prizrenit, sepse tashmë ju të gjithë e dini edhe qytetarët kanë mundësi më të mëdha për të parë se si do të duhej të ishte trashëgimia kulturore. Në vijim, tha se është për të ardhur keq që në Prizren janë dëmtuar shumë pjesët e trashëgimisë kulturore. Propozoi që si Komision, bashkërisht me KKTK-në, të organizojnë një ekspozitë në Bruksel ose në Strasburg, me qëllim që të promovohet më mirë realiteti i Kosovës, në aspektin e trashëgimisë kulturore.

**Albena Reshitaj**, tha se më ka lënë shumë përshtypje që keni nxjerrë Rregullore për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, për shkak se i keni kuptuar mangësitë e hasura ekzistuese. Më intereson ta di se ku jeni me këtë çështje, sepse për mua, kjo ka shumë rëndësi a keni arritur ta përfundoni këtë Rregullore. Ligji për trashëgimi kulturore, a është në përputhje me Ligjin nr. 06L 113 për organizim dhe funksionimin e administratës shtetërore, si dhe do të doja të informohesha, mungesa e hapësirës së ndërtesës, ku kemi mbërri në këtë pjesë?

**Zanita Halimi**, tha se lidhur me Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, është pothuajse në fazën finale. Po ashtu kemi miratuar edhe Rregulloren 02, që është për vlerësimin e aseteve në mbrojtje të përhershme. Sa i përket selisë, jemi në Grand dhe nuk është një zgjidhje e qëndrueshme. Meqë është në qendër, e kemi pasur një qasje më të lehtë, por që është e përkohshme.

**Eliza Hoxha**, tha se një gjë që e kam thënë edhe në takimin e kaluar, që Këshilli në këtë raport ka më shume aktivitete, që lidhen me edukim, me promovim, që nuk janë të dëmshme, por nuk është mandat direkt i Këshillit. Nëse i lexoni detyrat dhe përgjegjësitë, ju e kuptoni që keni mandat në gjithë territorin e Kosovës, mbi të gjitha institucionet, që në një formë ose tjetër, lidhen me zhvillimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, d.m.th. që ju jeni koka dhe koka midis këtyrë

institucioni që ju ka themeluar dhe institucioneve bartëse, të cilat duhet t'i monitoroni dhe bashkëpunoni në të njëjtën kohë. Më intereson të di për planet e menaxhimit, mendoj që duhet t'i kërkonit te ministria përgjegjëse. Sa i përket strategjisë, tha se ato janë përshkruese sesa që janë vepruese. Objektivat janë të thjeshta dhe nuk e di nëse është bërë një matje për të parë se a janë mbërrirë ose jo objektivat. Te përgjegjësitë e bordit, njëra nga pikat është komunikimi me KZMN-në, a keni kontaktuar ndonjëherë me KZMN-në dhe nëse po, për çfarë çështje. E dyta, propozoj hartimin e politikave nacionale për trashëgimi, pra neve na propozoni, Kuvendit, sepse nuk e kujtoj ndonjë ditë që neve na keni propozuar diçka, ndonjë ide se çka mund të veprojmë së bashku. Këshilli, gjithashtu duhet të sigurojë edhe donacione, a keni vepruar ndonjëherë në këtë drejtim, që të keni donacione shtesë për intervenime. Pika 4.8 e ligjit thotë se Këshilli identifikon dhe i propozon Kuvendit të Kosovës ndërmarrjen e masave për mbështetje financiare. Nuk e kujtoj që kemi diskutuar ndonjëherë për çështje të caktuara, për paratë që duhet t'i dedikohen proceseve të trashëgimisë kulturore. A ka pasur ndonjëherë ndonjë iniciativë për çështjen e artefakteve, që vazhdojnë të mbesin në Serbi dhe a ju ka shqetësuar çështja e Xhamisë së Çarshisë dhe me peizazhin e rikrijuar aty, sepse, nëse na e ndryshojmë historinë me restaurim, mendoj që është problem serioz këtu. Pra, ishte dashur që ta thoshit mendimin e juaj. Çështje tjetër është procedurale, ajo e Kreshnikut, që përtej mandatit njëvjeçar, sot vazhdon ta ushtrojë detyrën dhe një nga detyrat që i keni, është vendosja e strukturimi. Sa i përket anëtares së Këshillit, Ifeta, një tender është hapur për angazhim për punë në Drejtorinë për Trashëgimi Kulturore dhe jeni pranuar si punonjëse e angazhuar për projekte të caktuara të kësaj punëtorie. Për të kaluar nga ky Këshill, në një institucion që ju e monitoroni, ligjrisht nuk ka mundësi, sepse kjo është shkelje. Mendoj që është mirë ta përcaktoni dhe ta kuptoni që disa angazhime na i cenojnë disa angazhime.

**Zanita Halimi**, tha se kemi kontaktuar, por KZM-ja nuk është funksionale, e ka vetëm një sekretare, kemi pasur takime individuale, por jo si KZM, në tërësi. Sa i përket raportit të 23 aseteve, ne i kemi shkruar edhe manastireve, si institucion, por nuk janë përgjigjur, iu kemi shënuar edhe me email dhe me data që iu kemi drejtuar, por nuk jemi respektuar, si institucion. Sa i përket çështjeve të masave të domosdoshme, ne i kemi lidhur me raportin e 23 aseteve, kemi një strategji nacionale për trashëgimi kulturore, që është valide deri në vitin 2027, por të gjithë e dimë se ajo nuk monitorohet. Për këtë arsye nuk kemi marrë iniciativë për të vënë një plan nacional. Ndoshta, këtu ka vend për kritikë, që ne është dashur ta marrim dhe ta monitorojmë atë strategji nacionale, si proces, dhe punën në bazë të atij dokumenti. Sa i përket punës së artefakteve, ne gjithmonë e kemi si rast. Ne kemi edhe zyrtar serb në Këshill, të cilit i kemi kërkuar edhe ndihmë për disa çështje. Konkursi ka qenë vazhdimisht, tani jemi në një fazë ku duhet të kërkojmë nga institucionet, i kemi emailat që iu kemi shkruar dhe kemi marrë një zyrtar nga burimet njerëzore, që të na asistojë edhe për konkurs.

**Ardian Gola**, tha se në mbledhjen e ardhshme, Komisioni do të shqyrtojë dhe do ta plotësojë formën e Rezolutës për raportin vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2022, e cila do të procedohet në Kuvend për miratim.

#### **4. Formimi i grupit punues për mbikëqyrje për zbatimin e ligjeve**

**Ardian Gola**, tha se bëhet fjalë për formimin e dy grupeve punuese. NDI ka shprehur gatishmërinë, që të na ndihmojë në monitorimin e zbatimit të ligjeve në fushën e arsimit, dhe nga ligjet që janë aktualisht në fuqi, të cilat janë vlerësuar paksa si problematike, janë Ligji për profesionet e rregulluara dhe Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional. Ky i fundit, tashmë është

në proces të rishikimit në nivel të Qeverisë dhe derisa të vijë, është mirë ta monitorojmë dhe të shohim ku janë të metat.

Lidhur me mbikëqyrjen e Ligjit për arsimin dhe aftësimin profesional, Komisioni, pas diskutimeve, mori këtë:

V E N D I M

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional.

Grupi punues ka këtë përbërje: Ardian Gola, kryesues, Albena Reshitaj, Arijeta Fejza, Vlora Dumoshi, Arjeta Rexhepi dhe Enis Kervan, anëtarë.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës, Komisioni mori këtë:

V E N D I M

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës.

Grupi punues ka këtë përbërje: Vlora Dumoshi, kryesuese, Ardian Gola, Albena Reshitaj, Arijeta Fejza, Arjeta Rexhepi dhe Enis Kervan, anëtarë.

Komisioni, me shumicë votash, miratoi vendimet për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Ardian Gola,

---

Kryetar i Komisionit